# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442240**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gara për Prokuror të Përgjithshëm në ngërç, Arta Marku kërkon largimin e Sokol Stojanit nga procesi |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/gara-per-prokuror-te-pergjithshem-ne-ngerc-arta-marku-kerkon-largimin-e--i585947` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 07:49:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 09:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fd081c7fa641dd944453873fcda441a66189427e044236146a69b157adbf5d93` |
| TEKSTI | `9aabf025a97df40dd3f432af320a71c73575d57bec05899db9884a8ab264e4f3` |
| PAMJA | `8250119ac6a3bf2014645947cf85428a95a375091d03585ff78a1df7fff66bcf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9a25580e22c55d9e94c23e83f115f25e45d78663390b361c69cc835661e4a731` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9a25580e22c55d9e94c23e83f115f25e45d78663390b361c69cc835661e4a731`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gara për Prokuror të Përgjithshëm në ngërç, Arta Marku kërkon largimin e Sokol Stojanit nga procesi

TemA
14 Shtator 2026, 11:00Kronika TEMA




Vazhdon ngërçi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë për procesin e garës për Prokuror të Përgjithshëm. Një tjetër kandidate ka kërkuar dorëheqjen nga ky proces të një anëtari të KLP-së.

Sipas burimeve të gazetares së Top Channel, Anila Hoxha, kandidatja Arta Marku, që shfaq për herë të dytë dëshirën për të konkurruar për postin e Prokurores së Përgjithshme, ka kërkuar dorëheqjen e anëtarit të KLP-së, Sokol Stojani.

Arsyetimi i prokurores Marku është se ka konflikt interesi dhe se, sipas saj, Stojani nuk do ta vlerësojë pa emocione emrin e saj në garë, pasi kur ka qenë Prokurore e Përgjithshme e Përkohshme, ajo ka larguar nga posti i drejtorit të hetimit, në atë kohë, zotin Sokol Stojani.

Më herët janë kërkuar edhe dorëheqje të tjera të anëtarëve nga vetë anëtarët e KLP-së, duke e futur procesin në një parodi, pasi, teksa kanë kaluar afatet për t'ia përcjellë ILDKPKI-së formularët e kandidatëve, Këshilli ende nuk ka zgjidhur problemet e brendshme.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Protestuesit tentojnë të bllokojnë rrugën tek "Zogu i Zi", policia ndërhyn dhe shoqëron disa persona

09:42 Kronika

Ngjarje e rëndë në Roskovec/ Sulmoi me çekiç babain e ish-bashkëjetueses, i plagosuri dërgohet me urgjencë në spital, autori arratiset

09:00 Kronika

[Kishte dalë me leje nga burgu, Alket Rizai përfshihet në një konflikt me armë zjarri në Greqi]

07:29 Kronika / 2 komente

[Ndryshon vettingu për policët, lëvizja nga detyra nuk do t'i shpëtojë më zyrtarët nga verifikimi]

21:00 Kronika / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.